UDHËZIM
Nr.103, datë 14.2.2014

PËR RREGULLIMIN E DISA ÇËSHTJEVE QË KANË TË BËJNË ME PROCEDURËN E DHËNIES SË LEJEVE SHPËRBLYESE APO TË VEÇANTA PERSONAVE TË DËNUAR ME BURGIM

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7 dhe të nenit 16 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 59, 60, 61 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, të neneve 67, 68, 69, 70 të vendimit nr. 303, datë 25.3.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës dhe dhënien e lejeve shpërblyese në burgjet e sigurisë së zakonshme dhe të ulët, dhe për dhënien e lejeve të veçanta personave të burgosur. Për qëllim të këtij udhëzimi, fjalët "personat e burgosur" kanë të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 2, pika 2, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Regjistrimi i kërkesave të personave të burgosur për leje shpërblyese apo të veçantë bëhet në një regjistër të veçantë, të krijuar për këtë qëllim, i cili titullohet "Regjistri i lejeve shpërblyese dhe të veçanta të IEVP-së (emri i institucionit)". Formati i këtij regjistri duhet të jetë sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Kërkesa për leje shpërblyese apo të veçantë drejtuar drejtorit të IEVP-së, që paraqet personi i burgosur, është sipas formatit në aneksin nr. 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. IEVP-ja merr masa për t'u siguruar të burgosurve kopje të kërkesës për leje shpërblyese apo të veçantë në mjediset e përbashkëta të institucionit, siç mund të jenë mensa, biblioteka apo mjedise të tjera të ngjashme.

4. Me marrjen e kërkesës për leje shpërblyese nga i dënuari, pas protokollimit të saj, një kopje qëndron në sekretari dhe një kopje e merr vetë i dënuari, ndërsa drejtori i IEVP-së, brenda tri ditëve, nxjerr një urdhër me shkrim për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për leje shpërblyese nga sektorët përgjegjës në IEVP. Pas shqyrtimit të kërkesës, drejtori i IEVP-së me shkresë të veçantë njofton drejtorin e përgjithshëm, i cili vendos për planifikimin e lejes.

5. Drejtoritë e IEVP-ve, në çdo fillim viti, dërgojnë listën vjetore të të dënuarve që plotësojnë kriteret ligjore për trajtim me leje shpërblyese, të ndarë sipas muajve kalendarikë dhe të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

6. Drejtori i përgjithshëm i burgjeve, pas shqyrtimit të listës së të dënuarve që plotësojnë kriteret ligjore për t'u trajtuar me leje shpërblyese, bën planifikimin vjetor të tyre për të gjitha IEVP-të.

7. Planifikimi i lejeve shpërblyese për të dënuarit bëhet nga një grup pune i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, me pjesëmarrjen edhe të një specialisti të SHKB-së.

8. Lista e planifikuar nga DPB-ja të zbatohet me korrektësi nga drejtoritë e IEVP-ve dhe nuk duhet të shkelet në asnjë rast. Në qoftë se të dënuarit e planifikuar shkelin rregullat pas planifikimit, nuk duhet të shkojnë me leje shpërblyese, edhe po të jenë të planifikuar. Ditën e dhënies së lejes, drejtori i institucionit dhe sektorët përkatës bëjnë ose jo konfirmimin e raporteve të hartuara nga ana e tyre.

9. Raporti që përgatit sektori ligjor gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje shpërblyese, sipas shkronjës "b" të nenit 68 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, është sipas formatit të aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

10. Raporti i përbashkët që përgatit sektori i sigurisë dhe i kujdesit social, gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje shpërblyese, sipas shkronjës "c" të nenit 68 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të jetë sipas formatit në aneksin nr. 4, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

11. Raporti i përbashkët që përgatit sektori ligjor, i sigurisë dhe i kujdesit social, gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje të veçantë, sipas shkronjës "c" të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të jetë sipas formatit në aneksin nr. 5, të ndryshuar, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

12. Drejtori i IEVP-së:

a) Pasi shqyrton kërkesën dhe raportet e sektorit ligjor, kujdesit social dhe të sigurisë, brenda 24 orëve nga shqyrtimi, i kthen përgjigje me shkrim të burgosurit lidhur me refuzimin e motivuar ose miratimin e lejes shpërblyese, sipas formateve në aneksin nr. 8 dhe nr. 8/1, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi. Njëkohësisht, bazuar në këto kërkesa të miratuara në parim, që plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar leje shpërblyese, drejtori i IEVP-së i dërgon shkresë drejtorit të përgjithshëm për të bërë planifikimin.

b) 24 orë para ditës së planifikuar për leje, drejtori i IEVP-së nxjerr urdhrin për miratimin e lejes shpërblyese, sipas formatit në aneksin nr. 9, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Me këtë urdhër njihet edhe i burgosuri, i cili firmos në kopjen që mbahet në arkivin e IEVP-së.

c) I dënuari, në ditën që do të shkojë me leje shpërblyese, pajiset me dy kopje të dokumentacionit "Leje shpërblyese", sipas formatit në aneksin nr. 10, një kopje të të cilit do ta dorëzojë në komisariatin të vendqëndrimit.

d) IEVP-ja përkatëse dërgon njoftim me shkrim dhe komunikon përmes telefonit me komisariatin ku ka vendbanimin i dënuari, që ka përfituar leje shpërblyese, duke e informuar atë sipas formatit në aneksin nr. 11, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

13. Për të gjithë të dënuarit që do të shkojnë me leje shpërblyese, për të cilët ka informacione të pakonfirmuara se mund të kenë edhe dënime ose

probleme në shtete të tjera, vendime gjyqi të tjera, brenda ose jashtë shtetit, duhet të kërkohet paraprakisht informacion për to në prokuroritë dhe komisariatet e vendbanimit të të dënuarve, për ekzistencën e vendimeve të tilla, hetimeve në vazhdim etj.

14. Punonjësit e kujdesit social, përpara hartimit të raporteve për lejet shpërblyese, duhet të marrin në konsideratë masat e marra (të paktën një vit pa masa), takimet me të afërmit, sjelljet me të burgosurit dhe punonjësit në institucion, natyrën dhe llojin e veprës së kryer.

15. Për të pasur një ide më të qartë për qëndrimin, natyrën e dënimeve që ka i dënuari, shkallën e rehabilitimit të tyre, punonjësit e sektorit ligjor dhe ata të kujdesit social duhet që të shfrytëzojnë vendimet e gjykatës që ndodhen në dosje dhe dëshminë e penalitetit të të burgosurve. Është e nevojshme që të gjitha dosjet personale të të dënuarve të plotësohen me dëshmitë e penalitetit për të gjitha dënimet e mëparshme që mund të kenë pasur të dënuarit (pika 6 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve).

16. Dokumentacioni i cili ka shërbyer për dhënien e një lejeje shpërblyese është si më poshtë:

a) Kërkesa e të dënuarit sipas formatit në aneksin nr. 2;

b) Urdhri i drejtorit për fillimin e procedurave të shqyrtimit, sipas formatit në aneksin nr. 7;

c) Kthim përgjigje për të burgosurin, sipas formatit në aneksin nr. 8 dhe 8/1;

d) Raport i sektorit ligjor, sipas formatit në aneksin nr. 3;

e) Raporti i sektorit të kujdesit social dhe të sigurisë, sipas formatit në aneksin nr. 4;

f) Dinamika e vuajtjes së dënimit;

g) Urdhri për miratimin e lejes, sipas formatit në aneksin nr. 9;

h) Dokumentacioni “Leje shpërblyese”, që merr i burgosuri me vete, sipas formatit në aneksin nr. 10;

i) Njoftim për komisariatin, sipas formatit në aneksin nr. 11.

17. Vlerësimi i sjelljes së të burgosurve për leje shpërblyese bëhet nga komisioni i vlerësimit të sjelljes në IEVP dhe administrohet në dosjen personale të të burgosurit.

18. Sjellja e të burgosurit vlerësohet e mirë në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) Kur i burgosuri nuk ka paraqitur rrezikshmëri të veçantë shoqërore, brenda një viti nga paraqitja e kërkesës.

b) Kur gjatë vuajtjes së dënimit dhe në mënyrë të vazhdueshme i burgosuri ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektese në sjelljen e tij personale në marrëdhëniet me personelin e IEVP-së, si dhe në aktivitetet e organizuara nga institucioni.

c) Kur i burgosuri krijon besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit.

d) Kur i burgosuri tregon qëndrim korrekt dhe joagresiv ndaj personelit të IEVP-së, si dhe ndaj vizitorëve që hyjnë në institucion dhe nuk ka kryer kundër tyre veprime, që sipas Kodit Penal konsiderohen vepra penale.

e) Kur i burgosuri ka respektuar afatet në rikthimin e tij në institucion, pas lejeve të mëparshme të dhëna.

f) Kur i burgosuri i bindet urdhrave të dhëna nga personeli i IEVP-së.

g) Kur i burgosuri nuk ka nxitur apo nuk është përfshirë në rebelimin (revoltën) e të burgosurve brenda IEVP-së.

h) Kur i burgosuri nuk ka përdorur dhunë ndaj të burgosurve të tjerë apo punonjësve të institucionit, me qëllim pengimin e ushtrimit të detyrës apo të shërbimit.

i) Kur i burgosuri nuk ka tentuar më parë të largohet pa leje apo nuk është larguar nga vendi i qëndrimit të tij të detyrueshëm.

j) Kur i burgosuri nuk ka treguar neglizhencë në kryerjen e detyrave të caktuara nga personeli i IEVP-së.

k) Kur i burgosuri me sjelljen e tij nuk simulon në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore.

l) Kur i burgosuri nuk ka kryer akte apo vepra të tjera, të cilat cenojnë dukshëm qetësinë dhe moralin në IEVP.

m) Kur i burgosuri nuk ka mbajtur ose shpërndarë sende që mund të përdoren për të dëmtuar jetën, shëndetin, e personave të tjerë, sigurinë në institucion apo sende personale, që janë të ndaluara për t’u mbajtur në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

n) Kur i burgosuri ka treguar administrim dhe kujdes të mirë për sendet apo pajisjet e institucionit, duke mos i dëmtuar apo përvetësuar ato.

o) Kur i burgosuri nuk ka treguar neglizhencë në higjienën dhe mbajtjen e pastër dhe të rregullt të tij, si dhe në mbajtjen pastër dhe në mënyrë të rregullt të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

p) Kur i burgosuri nuk ka kryer aktivitete të tjera që janë të ndaluara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe në rregulloren e IEVP-së.

q) Kur i burgosuri nuk ka kryer veprime ose mosveprime, që kanë cenuar liritë dhe të drejtat themelore të të burgosurve të tjerë.

19. Sektori i kujdesit social dhe i sigurisë në IEVP, gjatë periudhës së lejeve shpërblyese apo të veçanta, vëzhgon dhe regjistron sjelljet e veçanta të çdo të burgosuri në një regjistër të posaçëm, që përditësohet çdo javë nga këta sektorë. Shënimet e regjistrit administrohen në dosjen personale të të burgosurit.

20. Drejtori i IEV Penale:

a) Me marrjen e kërkesës për leje të veçantë nga i burgosuri, ai brenda një dite nxjerr një urdhër me shkrim për fillimin e proceduarve për dhënien e lejes së veçantë nga sektorët përgjegjës, sipas formatit në aneksin nr. 7/1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

b) Pasi shqyrton kërkesën dhe raportin e përbashkët të sektorit ligjor, kujdesit social dhe të sigurisë, brenda ditës ai i kthen përgjigje me shkrim të burgosurit lidhur me

miratimin ose refuzimin e motivuar, sipas formatit në anekset nr. 8/2 dhe nr. 8/3 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

c) Për personat e burgosur, që u është miratuar leja e veçantë, nxirret urdhrime e shkrim i drejtorit të IEV Penale, sipas formatit në aneksin nr. 9/1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

d) Drejtori i IEV Penale përcakton në urdhër edhe mënyrën, kushtet, mjetet e shoqërimit të të burgosurit me forcat e policisë së burgjeve dhe numrin e tyre.

I burgosuri, pasi i është miratuar leja e veçantë, pajiset me dy kopje të dokumentacionit "Leja e veçantë", sipas formatit në aneksin nr. 10/1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, një kopje të të cilit do ta dorëzojë në komisariatin e policisë që ka në juridiksion vendqëndrimin e tij.

21. Sektori i sigurisë pranë IEV Penale harton një raport paraprak për komunikimin me komisariatin e policisë që ka në juridiksion vendqëndrimin e të burgosurit, që do të pajiset me leje të veçantë lidhur me rrezikshmërinë e të burgosurit, sipas formatit në aneksin nr. 12 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

22. IEV Penale njofton me shkrim (dhe në komunikim me telefon) brenda 24-orësh drejtorinë e policisë së qarkut dhe komisariatin e policisë së rrethit që ka në juridiksion vendbanimin e të burgosurit për dhënien e lejes së veçantë të burgosurit, sipas formatit në aneksin nr. 11, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

23. IEVP-ja njofton me shkrim (dhe në komunikim me telefon) drejtorinë e policisë së qarkut dhe komisariatin e policisë së rrethit që ka në juridiksion vendbanimin e të burgosurit për kthimin e tij nga leja e veçantë, sipas formatit në aneksin nr. 11/1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

24. Për lejet e veçanta që jepen në rastet e sëmundjeve të rënda, që rrezikojnë jetën e një anëtari të familjes (nëna, babai, fëmijët, motra, vëllai dhe bashkëshorti/bashkëshortja), i burgosuri duhet të paraqesë tek drejtori i institucionit dokumentet e mëposhtme provuese:

a) Kërkesën për leje të veçantë, të plotësuar sipas formatit në aneksin nr.2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi;

b) Dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me të sëmurin, i cili duhet të jenë të lëshuar jo më parë se 10 (dhjetë) ditë nga organet kompetente;

c) Vërtetimet e njësive vendore të pushtetit lokal duhet të jenë të lëshuara jo më parë se 10 (dhjetë) ditë nga momenti i dorëzimit të dokumenteve për leje pranë IEV Penale.

d) Dokumentin që provon sëmundjen e rëndë, të lëshuar nga spitali publik apo privat ku është trajtuar familjari i sëmurë, me datën e lëshimit të epikrizës, datën e shtrimit (trajtimit) në spital, numrin e kartelës, pavionin ku është shtruar, lëshuar me firmën e tre mjekëve, vulat personale të tyre, si dhe vulën e institucionit që e lëshon të konfirmuar nga drejtori i institucionit mjekësor, numrat e telefonit të tre mjekëve dhe spitalit, për të konfirmuar vërtetësinë e dokumentacionit. Epikriza mjekësore, që lëshohet për sëmundjet e familjarëve të të burgosurve duhet të jetë me tri firma, origjinale (jo fotokopje) dhe duhet të paraqitet brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të saj.

e) Kopje të dokumentit të letërnjoftimit të të burgosurit. Certifikatat duhet të jenë të lëshuara jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë.

25. Për qëllim të këtij udhëzimi, me sëmundje të rëndë do të kuptohet çdo sëmundje që lidhet me çrregullime fizike, që cenojnë ose vënë në rrezik në mënyrë të dukshme integritetin fizik apo jetën e anëtarit të familjes së të burgosurit (nëna, babi, fëmijët, motra, vëllai dhe bashkëshorti/ja), në atë masë që mund të sjellin si pasojë vdekjen e tij dhe që për këtë shkak kërkon kujdes të veçantë mjekësor.

26. Kur shkaku i lejes së veçantë është sëmundja e rëndë e anëtarit të familjes së personit të burgosur, dokumenti mjekësor që shoqëron kërkesën për leje të veçantë vlerësohet edhe nga përgjegjësi i sektorit të shëndetësisë në IEVP, ose në mungesë të tij nga mjeku i IEVP-së, i cili bën aktverifikim të epikrizës mjekësore, duke kontrolluar të gjithë elementet që provojnë vërtetësinë e saj. Pas kësaj, ai shprehet me shkrim për shkallën e rrezikshmërisë së sëmundjes së anëtarit të familjes së të burgosurit, kontrollon përmes komunikimit me telefon me qendrën spitalore ku është shtruar i sëmuri ose me mjekët që kanë nëshkruar epikrizën. Aktverifikimi i mjekut dhe mendimi i tij me shkrim hartohet sipas formatit në aneksin nr. 6, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

27. Mendimi me shkrim nga përgjegjësi i sektorit të shëndetësisë ose mjeku në IEVP ose në mungesë të tij, nga mjeku i IEVP-së për sëmundjen e anëtarit të familjes së të burgosurit që kërkon leje të veçantë, duhet të jetë në përputhje me formatin në aneksin nr.6, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

28. Mendimi me shkrim i mjekut, me propozimin për dhënien ose jo të lejes së veçantë, duhet të merret parasysh përpara përgatitjes së raportit të përbashkët nga ana e sektorit ligjor, sigurisë dhe kujdesit social në IEVP.

29. Leja e veçantë jepet për shkak të sëmundjes së rëndë, që rrezikon jetën e prindërve, bashkëshortit / bashkëshortes, fëmijëve, motrës, vëllait të të burgosurit.

30. Leja e veçantë duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesa e të dënuarit sipas formatit në aneksin nr. 2;

b) Urdhrin e drejtorit për fillimin e procedurave të shqyrtimit, sipas formatit në aneksin nr. 7/1;

c) Kthim përgjigje të burgosurit, sipas formatit në aneksin nr. 8/2 ose 8/3;

d) Epikriza mjekësore e të sëmurit;

e) Raportin e përbashkët të sektorëve përkatës, sipas formatit në aneksin nr. 5;

f) Aktverifikimi i mjekut për epikrizën sipas formatit në aneksin nr. 6;

g) Raportin me shkrim të sektorit të shëndetësisë,

sipas formatit në aneksin nr. 6;

h) Dinamika e vuajtjes së dënimit;

i) Raport paraprak i sektorit të sigurisë, për komunikimin me komisariatin lidhur me rrezikshmërinë e të burgosurit, sipas formatit në aneksin nr. 12;

j) Urdhri për miratimin e lejes, sipas formatit në aneksin nr. 9/1;

k) Dokumentacioni që merr i burgosuri me vete, sipas formatit në aneksin nr. 10/1;

l) Njoftim për drejtorinë e policisë së qarkut dhe komisariatin që ka në juridiksion vendqëndrimin e të burgosurit, sipas formatit në aneksin nr. 11.

m) Njoftim për drejtorinë e policisë së qarkut dhe komisariatin që ka në juridiksion vendqëndrimin e të burgosurit, që personi u kthye nga leja, sipas formatit në aneksin nr. 11;

n) Deklarata e familjarëve, sipas formatit në aneksin nr. 14;

31. Leja e veçantë jepet për shkak të vdekjes së prindërve, bashkëshortit/es, fëmijëve, motrave apo vëllezërve.

32. Për lejet e veçanta, që jepen në rastet e vdekjes së anëtarit të familjes (prindër, bashkëshort/bashkëshorte, fëmijë, motër, vëlla), i burgosuri duhet të paraqesë tek drejtori i institucionit dokumentet e mëposhtëm provues:

a) Kërkesën për leje të veçantë, të plotësuar sipas modelit tip të aneksit nr.2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

b) Dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me anëtarin e familjes që ka vdekur.

c) Certifikatën e vdekjes së anëtarit të familjes së të burgosurit, lëshuar nga autoriteti përgjegjës shtetëror apo vërtetimin nga mjeku i zonës përkatëse, ku ka ndodhur vdekja (mjek, qendër shëndetësore, spital, urgjencë), në përputhje me ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar. Për vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor dhe është i nënshkruar nga prokurori.

d) Kopje të dokumentit të certifikatës së të burgosurit.

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë.

33. Për lejet e veçanta që jepen në rastet e lindjes së anëtarit të familjes, i burgosuri duhet të paraqesë tek drejtori i institucionit dokumentet e mëposhtme provuese:

a) Kërkesën për leje të veçantë, të plotësuar sipas modelit tip të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi;

b) Dokumentacionin nga gjendja civile, që provon lidhjen familjare të të burgosurit me anëtarin e familjes;

c) Certifikatën e lindjes së anëtarit të familjes së të burgosurit apo vërtetimin nga çdo subjekt shëndetësor, shtetëror apo privat, që sipas ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, kanë të drejtë të njoftojnë lindjen dhe njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucionit të tyre.

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë.

34. Leja e veçantë jepet për shkak të lindjes së fëmijëve, motrave apo vëllezërve të të burgosurit.

35. Leja e veçantë jepet për shkak të martesës së prindërve, fëmijëve, motrave apo vëllezërve të të burgosurve dhe martesën e vetë të burgosurit.

36. Për lejet e veçanta që jepen në rastin e martesës së anëtarit të familjes ose vetë të burgosurit, ky i fundit duhet të paraqesë tek drejtori i institucionit dokumentet e mëposhtme provuese:

a) Kërkesën për leje të veçantë, të plotësuar sipas modelit tip të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi;

b) Certifikatën e martesës së anëtarit të familjes së të burgosurit, kërkesën për shpallje martese të lëshuar nga bashkia apo komuna, ku secili nga bashkëshortët e ardhshëm ka vendbanimin ose vendqëndrimin;

c) Kopje të dokumentit të certifikatës së të burgosurit;

d) Vërtetimin e njësisë vendore që vërteton datën e zhvillimit të ceremonisë së martesës nga të dy bashkëshortët.

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kërkesës për leje të veçantë.

37. Leja shpërblyese apo e veçantë miratohet nga drejtori i IEVP-së, vetëm pasi të jetë i planifikuar nga DPB-ja dhe të ketë marrë të paktën dy mendime në favor të miratimit të saj, sipas raporteve të përgatitura nga sektori i sigurisë, ligjor dhe kujdesit social.

38. Leja e veçantë jepet me shoqërim, në rastet kur drejtori i institucionit ka informacion të mjaftueshëm se i burgosuri nuk ka besueshmëri, në rastet kur akuzohet për vepra penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Ndërsa për të dënuarit që kanë më shumë se 5 vite burg për të vuajtur, nuk do të miratohet leje e veçantë pa shoqërim.

Leja e veçantë me kohëzgjatje deri në 12 orë për të burgosurit bëhet më shoqërim vetëm në kushtet kur ka ndriçim natyral. Drejtori që jep lejen përcakton në urdhrin e dhënies së lejes së veçantë kushtet, mjetet e shoqërimit të të burgosurit me forca të policisë së burgjeve dhe numrin e tyre.

39. Të gjitha lejet shpërblyese dhe të veçanta të dhëna regjistrohen në një regjistër të veçantë, të krijuar për këtë qëllim, i cili titullohet "Regjistri i lejeve shpërblyese dhe të veçanta të IEV Penale". Formati i këtij regjistri është sipas formatit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

40. Dokumentacioni i cili do të përdoret për fillimin e procedurave për lejet e veçanta, të dorëzohet në sekretarinë e institucionit nga familjari, ku ky i fundit duhet të plotësojë një formular vetëdeklarimi, sipas formatit në aneksin nr.14, me përgjegjësi për vërtetësinë dhe autenticitetin e materialit që dorëzon. Në këtë formular, të pasqyrohet vendbanimi i saktë i dorëzuesit, numrat e dokumentit identifikues (kartë identiteti ose pasaportë biometrike), numri i celularit e të tjera të dhëna që identifikojnë me saktësi gjeneralitetet e dorëzuesit.

41. Drejtori i IEV Penale i dërgon drejtorit të

përgjithshëm të burgjeve dhe Ministrit të Drejtësisë brenda 24 orëve nga miratimi i lejes, njoftimin për dhënien e lejes shpërblyese ose të veçantë dhe brenda 5 ditëve, të gjithë dokumentacionin që ka shërbyer për të miratuar këtë leje.

42. Në fillim të vitit drejtori i përgjithshëm i dërgon drejtorive të IEV Penale dhe Ministrit të Drejtësisë planifikimin vjetor të lejeve shpërblyese për të dënuarit.

43. Udhëzimi me nr. 7087, datë 10.9.2009 “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të burgosur”, shfuqizohet.

44. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

Aneksi nr. 1

REGJISTRI I LEJEVE SHPËBLYESE DHE TË VEÇANTA TË I.E.V.P.-së_____

Nr.	Emri / mbiemri i të burgosurit	Lloji i lejes së dhënë	Masa e dënimit	Dënimi i mbetur	Data e fillimit të lejes	Data e mbarimit të lejes	Shkaku i lejes	Leje e Miratuar/ refuzuar
1.								
2.								
3.								
4.								
5.								
6.								
7.								
8.								
9.								
10.								
11.								
12.								
13.								
14.								
15.								
16.								
17.								
18.								
19.								
20.								
21.								
22.								
23.								
24.								
25.								

REGJISTRI I KËRKESË-ANKESAVE TË TË BURGOSURVE PËR LEJE SHPËRBLYESE DHE TË VEÇANTË

Nr.	Emër, atësia, mbiemër	Data e protokollimit të kërkesës	Objekti i kërkesë/ankesës		Miratimi ose refuzimi) Po/jo	Data e kthimit të përgjigjes me shkrim	Nënshkrimi
			Shpërblyese	E veçantë			

Aneksi nr. 2

Datë_____

KËRKESË

Lënda: Kërkesë për leje _____ *(shpërblyese /apo të veçantë)*

Drejtuar: Drejtorit të IEVP-së _____

IEVP _____ *(emri i burgut)*

Me anë të kësaj kërkese, unë i nënshkruari_____, bazuar në nenet 59-61, të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, dhe në nenet 67-70 të vendimit nr. 303, datë 25.3.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së përgjithshme te burgjeve", kërkoj leje _____,për_____ditë (të shkruhet edhe me fjalë).
Shkaku ligjor për dhënien e lejes është:
_____
_____
_____
_____
(Sjellja e mirë, sëmundje e rëndë e cila rrezikon jetën e anëtarit të familjes, ngjarje e rëndësishme familjare, si vdekje, lindje apo martese).

Për sa më sipër, mbetem në pritje të përgjigjes tuaj.
Me respekt,

Emër/mbiemër
(nënshkrimi)

Aneksi nr. 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale_____

Nr._____Prot. **Datë___/____/___**

RAPORT I SEKTORIT LIGJOR

Lidhur me kërkesën për leje shpërblyese, të shtetasit/shtetases të dënuar me burgim

Z./znj. _____

Drejtuar: Drejtorit të IEVP-së _____
Bazuar në nenin 59 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar dhe në shkronjën "b" të nenit 68 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr**.** 303, datë 25.3.2009 "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve", ju informoj se shtetasi është dënuar me_____ vjet,_____ muaj,_____ditë burgim dhe po vuan dënimin në burgun e sigurisë së *zakonshme/të ulët).*
Deri më sot ai ka vuajtur_____vjet ____muaj, ditë burgim dhe ka për të vuajtur edhe _____vjet_____muaj _____ditë burgim.
Për rrjedhojë, kërkuesi **plotëson/nuk plotëson kohëzgjatjen e vuajtjes së** dënimit për të marrë leje shpërblyese që është _____(1/4, 1/2, 2/3) e dënimit me burgim.
Shtetasi _____ ka përfituar _____ ditë leje që nga fillimi i vitit dhe leja e fundit shpërblyese është dhënë në datën __/__/____. *(Në çdo rast, nga miratimi i lejes shpërblyese të fundit duhet të kenë kaluar të paktën 3 muaj, pika 2, neni 68, i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 25.3.2009 "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve")*
Për sa më sipër, meqenëse shtetasi i burgosur _____ plotëson/ nuk plotëson kriteret ligjore dhe nënligjore, propozoj t'i jepet/të mos i jepet leje shpërblyese, në masën _____ditë.

Përgjegjësi i sektorit ligjor
_____

Aneksi nr. 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale_____

Nr_____Prot. **Datë___/____/___**

RAPORT I SEKTORIT TË SHERBIMIT TË KUJDESIT SOCIAL DHE TË SIGURISË
Mbi vlerësimin e sjelljes për leje shpërblyese të shtetasit/shtetases të dënuar

Z./znj._____
Mbështetur në kërkesën e tij/saj për leje shpërblyese
Drejtuar: Drejtorit të institucionit z./znj. _____
IEV Penale_____

Bazuar në nenin 59 të ligjit nr. 8328, datë 16/04/2009 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, të nenit 68 pika (c) të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 25.3.2009 "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve", gjatë shqyrtimit të kërkesës për leje shpërblyese të shtetasit/ses të dënuar _____, sektori i shërbimit të kujdesit social ju informon se:
Shtetasi/ja , _____ i/e cili/a po vuan dënimin me burgim në IEVP _____

1. Ka shfaqur sjellje pozitive duke mos paraqitur rrezikshmëri shoqërore brenda një viti nga paraqitja e kërkesës.
Po ❑ **J o ❑**

Nëse "Jo" sqaro shkakun:
_____
_____

2. Tregon qëndrim korrekt dhe jo agresiv në marrëdhëniet me personelin e IEV Penale, si dhe ndaj vizitorëve që hyjnë në institucion dhe nuk ka kryer kundër tyre veprime, që sipas Kodit Penal konsiderohen vepra penale.
Po ❑ **J o ❑**

3. Gjatë vuajtjes së dënimit në mënyrë të vazhdueshme ka marrë pjesë aktive në aktivitetet rehabilituese të organizuara në institucion dhe ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektësie.
Po ❑ **J o ❑**

4. Shprehet dhe ndjehet i/e penduar për veprën e kryer.
Po ❑ **J o ❑**

5. Krijon besimin e një qëndrimi të mirë jashtë institucionit.
Po ❑ **J o ❑**

6. Gjatë vuajtjes së dënimit në mënyrë të vazhdueshme ka shfaqur ndjenjë përgjegjësie dhe korrektësie në sjelljen e tij/saj personale, në marrëdhënie me bashkëvuajtësit.
Po ❑ **J o ❑**

Nëse "Jo" sqaro:
_____
_____

7. Ka respektuar afatet e rikthimit të tij në institucion pas lejeve të mëparshme të dhëna.
Po ❑ **J o ❑**

8. I është bindur urdhrave dhe ka treguar korrektësi në kryerjen e detyrave të caktuara nga personeli i IEV Penale.
Po ❑ **J o ❑**

Nëse "Jo" sqaro:
_____
_____

9. Nuk ka nxitur apo nuk është përfshirë në rebelimin (revoltën) e të burgosurve brenda IEV Penale apo në IEVP-të e tjera brenda një viti nga paraqitja e kërkesës.
Po ❑ **J o ❑**

Nëse "Jo" sqaro:

_____

_____

Po ❑ **J o ❑**

10. Nuk ka ofenduar apo nuk ka përdorur dhunë ndaj punonjësve të institucionit, me qëllim pengimin e ushtrimit të detyrës apo të shërbimit.

Po ❑ **J o ❑**

11. Nuk ka tentuar më parë të largohet pa leje apo nuk është larguar nga vendi i qëndrimit të tij të detyrueshëm.

Po ❑ **J o ❑**

12. Nuk simulon më gjendjen e tij shëndetësore. **Po ❑** **J o ❑**

13 . Nuk ka kryer akte apo vepra të tjera, të cilat cenojnë dukshëm qetësinë dhe moralin në IEV Penale.

Po ❑ **J o ❑**

Nëse "Jo" sqaro:

_____

_____

14. Nuk ka mbajtur ose shpërndarë sende që mund të përdoren për të dëmtuar jetën, shëndetin e personave të tjerë, sigurinë në institucion, apo sende personale që janë të ndaluara për t'u mbajtur në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Po ❑ **J o ❑**

15. Ka treguar kujdes të mirë në administrimin e sendeve apo pajisjeve të institucionit, duke mos i dëmtuar apo përvetësuar ato.

Po ❑ **J o ❑**

16. Ka treguar kujdes në higjienën dhe pamjen e pastër e të rregullt të tij, si dhe në mbajtjen pastër dhe në mënyrë të rregullt të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Po ❑ **J o ❑**

17. Nuk ka kryer aktivitete të tjera që janë të ndaluara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe në rregulloren e brendshme të IEV Penale.

Po ❑ **J o ❑**

Nëse "Jo" sqaro:

18. Nuk ka kryer veprime ose mosveprime që kanë cenuar liritë dhe të drejtat themelore të të burgosurve të tjerë.

Po ❑ **J o ❑**

Nëse "Jo" sqaro:

Për sa më sipër, meqenëse shtetasi/ja i/e dënuar plotëson/nuk plotëson kriteret ligjore dhe nënligjore, propozojmë t'i jepet/të mos t'i jepet leje shpërblyese.

Specialisti i sektorit të shërbimit të kujdesit social — Specialisti i sektorit të sigurisë

Përgjegjësi i sektorit të shërbimit të kujdesit social — Përgjegjësi i sektorit të sigurisë

Aneksi nr. 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale_____

Nr. .....Prot. **Datë___/____/___**

RAPORT I PËRBASHKËT I SEKTORËVE LIGJORË, TË SHËRBIMIT TË KUJDESIT SOCIAL DHE TË SIGURISË

Lidhur me kërkesën për leje të veçantë të shtetasit/ses të burgosur z./znj.

Drejtuar: Drejtorit të institucionit z./znj. _____
IEV Penale _____

